

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.112/2020, “PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me miratimin e ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, të gjitha subjektet raportuese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Gjithashtu, ky ligj parashikoi se subjektet raportuese ekzistuese duhet të regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues deri më datë 30.6.2021 (afat i shtyrë me anë të aktit normativ nr.12, datë 25.3.2021, miratuar me ligjin nr.55/2021). Ndërkohë që, bazuar në këtë ligj, subjektet raportuese të krijuara rishtazi kanë detyrimin të regjistrojnë pronarët e tyre përfitues brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues.

Megjithatë, nga analizimi i të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, rezulton se, nga 59165 subjekte raportuese ekzistuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, prej të cilëve 8689 subjekte me statusin pezulluar, bazuar në vendimin nr.273, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit dhe publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara””, kanë detyrimin të regjistrojnë pronarin përfitues në Regjistrin e Pronarit Përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në Regjistrin Tregtar, vetëm 21460 subjekte raportuese ekzistuese kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër deri më 10.11.2021.

Gjithashtu, nga 4861 organizata jofitimprurëse ekzistuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, vetëm 1961 organizata jofitimprurëse kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.

Ndërkohë, nga analiza e bërë rezulton se, nga 2869 subjekte raportuese të krijuara rishtazi pas krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues (gjatë periudhës kohore 1.2.2021-10.11.2021), vetëm 1972 subjekte kanë regjistruar të dhënat e pronarëve

të tyre përfitues në regjistër brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Me qëllim rregullimin e kësaj situate dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të *MONEYVAL*, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma që të sigurojnë një numër sa më të lartë të subjekteve raportuese, që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, u vlerësua ndërmarrja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

Me anë të këtij projektligji janë ndërmarrë disa ndryshime ligjore që mundësojnë:

- popullimin automatik të regjistrit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte;
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese me pronësi indirekte të regjistruara në regjistrin tregtar dhe nga Organizatat Jofitimprurëse, deri më datë 1.4.2022;
- aplikimin e njëkohshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues nga të gjitha subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, në momentin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik;
- miratimin e njëkohshëm të aplikimit për regjistrimin e pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar me pronësi direkte;
- për subjektet raportuese me pronësi indirekte, që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, për shkak të kompleksitetit të informacionit dhe dokumentacionit, miratimi bëhet brenda afatit 2-ditor, në përputhje me procedurat normale të ligjit; në rast të refuzimit të aplikimit për shkak të mangësive të aplikimit, këto subjekte detyrohen të riparaqesin aplikimin për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues brenda një afati 40-ditor.
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, nga brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese.
- faljen e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mospërmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues nga subjektet raportuese, pa i çliruar nga detyrimi që raportimi të kryhet prej tyre deri më 1.4.2022;
- përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit, mbi bazën e vonesës në përmbushjen

- e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi;
- parashikimin e procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30-ditor, në rast të aplikimeve të paplota;
 - heqjen e gjobës për administratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor dhe përfshirjen e vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese;
 - kalimin në status “të pezulluar”, sipas rastit, nga QKB-ja ose nga autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse, për subjektet raportuese, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues, brenda afateve të shtyra sipas parashikimeve të projektligjit. Në këto raste, QKB-ja ose nga autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse gjithashtu nuk do të ofrojnë shërbimet ndaj këtyre subjekteve raportuese deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues;
 - lejimin e ofrimit të shërbimit të ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave JoFitimprurëse.

Vlen të theksohet se afati i datës 1.4.2022, parashikuar në projektligj për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, konsideron miratimin e hyrjen në fuqi të projektligjit brenda muajit janar 2022.

Vlerësohet se, për realizimin e popullimit automatik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, të regjistrimit të pronarëve përfitues me të dhënat për subjektet raportuese ekzistuese të regjistruara në regjistrin tregtar, që kanë pronësi direkte, nevojitet një periudhë pune prej të paktën 2 muajsh.

Gjithashtu, për të mundësuar një numër sa më të lartë të raportimeve nga subjektet e tjera raportuese (me pronësi indirekte dhe organizatat jofitimprurëse), vlerësohet se një afat minimal prej 2 muajsh do të ishte i nevojshëm, pas hyrjes në fuqi të projektligjit, e botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

Rrjedhimisht, në rast se do të ketë vonesa në procesin e miratimit të projektligjit, do të nevojitej shtyrja e afatit të datës 1.4.2022 gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit në komisionet e Kuvendit apo në seancë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por vjen si një domosdoshmëri në kuadër të lehtësimit e të përmirësimit të zbatimit të detyrimit për procesin e regjistrimit të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji synon të nxisë rritjen e numrit e raportimeve të pronarëve përfitues, si dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të *MONEYVAL*-it, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma për sigurimin e një numri sa më të lartë të subjekteve raportuese, që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, ndaj dhe u vlerësua ndërmarrja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

Më konkretisht, ky projektligj parashikon ndryshimet, si më poshtë vijon:

- mundësinë e popullimit automatik të Regjistrimit të Pronarëve Përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, duke iu referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte;
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese me pronësi indirekte të regjistruara në regjistrin tregtar dhe nga Organizatat Jofitimprurëse, deri më 1.4.2022;
- aplikimin e njëkohshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues nga të gjitha subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, në momentin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik. Për shkak se aplikimi për regjistrimin në regjistrin tregtar të personave juridikë nuk mund të realizohet aktualisht *on-line*, edhe aplikimi i njëkohshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues do të duhet të realizohet në sportelet e QKB-së;
- miratimin e njëkohshëm të aplikimit për regjistrimin e pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në Regjistrin Tregtar me pronësi direkte. Për subjektet raportuese me pronësi indirekte, që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, për shkak të kompleksitetit të informacionit dhe dokumentacionit, miratimi bëhet brenda afatit 2-ditor, në përputhje me procedurat normale të ligjit; në rast të refuzimit të aplikimit për shkak të mangësive të aplikimit, këto subjekte detyrohen të riparaqesin aplikimin për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues brenda një afati 40-ditor.

- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, nga “brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese”, në “brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese”. Kjo shtyrje afati është bërë për arsye se aktualisht koha për t’u pajisur me nënshkrim elektronik është 7-10 ditë dhe kjo gjë krijon pengesa dhe vonesa për subjektet raportuese për regjistrimin e të dhënave të pronarëve të tyre përfitues në regjistër;
- faljen e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mospërmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, pa i çliruar nga detyrimi që raportimi të kryhet prej tyre deri më 1.4.2022;
- përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit mbi bazën e vonesës në përmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi. Ky përshkallëzim bëhet me qëllim mundësimin e rritjes së numrit të subjekteve raportuese që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër;
- parashikimin e procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30-ditor, në rast të aplikimeve të paplota. Kjo risi u mundëson subjekteve raportuese të rregullojnë të metat e konstatuara në aplikim gjatë afatit të pezullimit dhe të regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, si dhe të shmangin marrjen e gjobave;
- heqjen e gjobës për administratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor dhe përfshirja e vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese, duke mundësuar vjeljen e kësaj shume nga subjekti raportues. Ky ndryshim është parë i arsyeshëm për t’u bërë për arsye se, aktualisht, QKB-ja e ka të pamundur të vjelë nga përfaqësuesi ligjor kundërvajtjet administrative të vendosura, pasi e vetmja mënyrë për vjeljen e gjobave është ndërprerja e shërbimeve për subjektin raportues;
- kalimin në status “të pezulluar”, sipas rastit, nga QKB-ja ose nga autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, për subjektet raportuese, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues, brenda afateve të shtyra sipas parashikimeve të projektligjit. Në këto raste, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse gjithashtu nuk do të ofrojnë shërbime ndaj këtyre subjekteve raportuese deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues;
- lejimin e ofrimit të shërbimit të ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve

raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse. Ky parashikim është bërë pasi parashikimi aktual ligjor krijon problematika të shumta, duke qenë se subjektet raportuese e kanë të pamundur të emërojnë një përfaqësues të ri për të përmbushur detyrimet e raportimit, pasi ato nuk marrin shërbim nga Regjistri Tregtar ose në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, për arsye se ato nuk kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues brenda afateve ligjore.

Vlen të theksohet se afati i datës 1.4.2022, parashikuar në projektligj për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, konsideron miratimin e hyrjen në fuqi të projektligjit brenda muajit janar 2022.

Vlerësohet se, për realizimin e popullimit automatik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, të Regjistrin të Pronarëve Përfitues me të dhënat për subjektet raportuese ekzistuese të regjistruara në regjistrin tregtar që kanë pronësi direkte, nevojitet një periudhë pune prej të paktën 2 muajsh.

Gjithashtu, për të mundësuar një numër sa më të lartë të raportimeve nga subjektet e tjera raportuese (me pronësi indirekte dhe organizatat jofitimprurëse), vlerësohet se një afat minimal prej 2 muajsh do të ishte i nevojshëm, pas hyrjes në fuqi të projektligjit dhe botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

Rrjedhimisht, në rast se do të ketë vonesa në procesin e miratimit të projektligjit, do të nevojitej shtyrja e afatit të datës 1.4.2022 gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit në komisionet e Kuvendit apo në seancë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron asnjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 7 nene, nëpërmjet të cilëve bëhen disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, me

qëllim përmirësimit të tij në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor të subjekteve raportuese për regjistrimin e pronarit përfitues.

Neni 1 i projektligjit ndryshon shkronjën pikën 3, të nenit 5, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, duke parashikuar aplikimin e njëkohshëm me regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar, në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen në regjistrin tregtar rishtazi, si dhe duke zgjatur afatin e regjistrimit fillestar për subjektet e reja, nga “30” ditë në “40” ditë nga data e regjistrimit në regjistrin e organizatave jofitimprurëse. Gjithashtu, ky nen, për subjektet me pronësi indirekte, që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, parashikon detyrimin për riaplikim brenda një afati 40-ditor në rast të refuzimit të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, për shkak të mangësive të aplikimit.

Afati 90-ditor për regjistrimin e ndryshimeve në të dhënat e pronarëve përfitues, të regjistruara më parë sipas ligjit, mbetet sipas tekstit aktual të ligjit.

Neni 2 i projektligjit ndryshon pikat 4, 6 dhe 8, të nenit 6, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, si dhe shton pikat 4/1 e 4/2. Këto ndryshime bëhen për të mundësuar:

- paraqitjen e aplikimit të njëkohshëm me aplikimin për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar dhe miratimin e njëkohshëm të regjistrimit të të dhënave për pronarët përfitues të subjekteve raportuese me pronësi direkte që regjistrohen rishtazi në regjistrimin tregtar; si dhe
- pezullimin e aplikimit e dhënien e një afati 30-ditor për plotësimin e të metave të aplikimeve. Gjithashtu, neni 3 i projektligjit shton pikat 4/1 e 4/2, në nenin 6, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

Procedura e miratimit të njëkohshëm dhe e pezullimit do të detajohet më tej me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3 i projektligjit ndryshon nenin 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, duke parashikuar përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative të lidhura me mospërmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar nga subjektet raportuese, brenda afateve ligjore të ndryshuara sipas projektligjit, si dhe rregullon ngërçin e mundshëm që mund të krijohet në lidhje me gjobat ndaj përfaqësuesve ligjor e ndryshimin e të dhënave të tyre në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.

Konkretisht, në tekstin aktual të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, ndaj subjektit raportues që regjistrohet rishtazi, zbatohen kundërvajtjet administrative, si më poshtë vijon:

- Gjobë ndaj subjektit raportues për mosregjistrimin fillestar të të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda afatit ligjor, parashikuar në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë; dhe
- Gjobë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit raportues për të njëjtën shkelje, në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Sipas projektligjit, shuma prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh ndaj përfaqësuesit ligjor është përfshirë te gjoba maksimale për subjektin raportues, e cila shkon gjithsej 650 000 lekë (përshkallëzuar 50 000 lekë + 600 000 lekë).

I njëjti parim ndiqet edhe për mosregjistrimin e çdo ndryshimi në të dhënat e regjistruara dhe në dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistër, që në tekstin aktual të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, parashikon:

- gjobë ndaj subjektit raportues në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë; dhe
- gjobë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit raportues për të njëjtën shkelje, në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Sipas projektligjit, shuma prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh ndaj përfaqësuesit ligjor është përfshirë te gjoba për subjektin raportues, e cila shkon në masën 400 000 lekë.

Ky nen parashikon gjithashtu kalimin në status “të pezulluar”, sipas rastit, nga QKB-ja ose nga autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, për subjektet raportuese, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues, brenda afateve të shtyra sipas parashikimeve të projektligjit.

Në këto raste, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, gjithashtu, nuk do të ofrojnë shërbime ndaj këtyre subjekteve raportuese deri në pagimin e gjobës e regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues.

Përrjashtim nga ky rregull bëhet për rastin e ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese, në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.

Ky parashikim është bërë pasi parashikimi aktual ligjor krijon problematika të shumta, duke qenë se subjektet raportuese e kanë të pamundur të emërojnë një përfaqësues të ri për të përmbushur detyrimet e raportimit, pasi ato nuk marrin shërbim nga regjistrin tregtar ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse për arsye se ato nuk kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues brenda afateve ligjore.

Në përputhje me komentet e marra nga Ministria e Drejtësisë, gjoba për mospërmbushjen e detyrimeve për regjistrim nga subjektet raportuese ekzistuese, brenda afatit të shtyrë të datës 1.4.2022, është kaluar në nenin për dispozitat tranzitore të projektligjit.

Sa më sipër, i njëjti parim i bashkimit të gjobave për subjektin dhe për përfaqësuesin ligjor është ndjekur edhe në nenin e dispozitave tranzitore, për rastin e mospërmbushjes së detyrimit të subjekteve raportuese ekzistuese për regjistrimin e të dhënave të kërkuara nga afatit ligjor të ndryshuar.

Neni 4 i projektligjit shfuqizon pikën 3, të nenin 15, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, lidhur me afatin e regjistrimit që zbatohet ndaj subjekteve raportuese ekzistuese, të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore.

Në përputhje me komentet e marra nga Ministria e Drejtësisë, afati i ri i datës 1.4.2022, për mospërmbushjen e detyrimeve për regjistrim nga subjektet raportuese ekzistuese, është kaluar në nenin për dispozitat tranzitore të projektligjit.

Neni 5 i projektligjit përmban dispozita transitore.

Së pari, neni 5 i projektligjit parashikon mundësinë që QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, të popullojnë automatikisht Regjistrin e Pronarëve Përfitues për subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, të cilat kanë qenë të regjistruara në Regjistrin Tregtar, përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, duke iu referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar. Për subjektet ekzistuese të ndryshme nga sa më sipër (në pronësi indirekte dhe për organizatat jofitimprurëse), të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore brenda afatit, neni 5, i projektligjit, parashikon shtyrjen e afatit për regjistrimin fillestar dhe të ndryshimeve në të dhënat e pronarëve përfitues, deri më 1.4.2022.

Ky nen parashikon gjithashtu masën e kundërvajtjes administrative për moskryerjen e regjistrimeve përkatëse brenda afatit të shtyrë të datës 1.4.2022, si dhe mënyrën e konstatimit e të administrimit të gjobës.

Më konkretisht, ky nen parashikon se mospërbushja e detyrimeve për regjistrim fillestar nga subjekte me pronësi indirekte të regjistruara në regjistrin tregtar, si dhe nga organizatat jofitimprurëse, apo mospërbushja e detyrimeve për regjistrim të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues, brenda datës 1.4.2022, dënohet me gjobë në vlerën në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Për të mundësuar vjeljen e gjobës dhe përmbushjen e detyrimeve të raportimit, parashikohet kalimi në status “të pezulluar”, sipas rastit, nga QKB-ja ose nga autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, për subjektet raportuese, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues, brenda afateve të shtyra sipas parashikimeve të projektligjit.

Në këto raste, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, gjithashtu, nuk do të ofrojnë shërbime ndaj këtyre subjekteve raportuese deri në pagimin e gjobës e regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues.

Përjashtim nga ky rregull bëhet për rasatin e ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.

Ky parashikim është bërë pasi parashikimi aktual ligjor krijon problematika të shumta, duke qenë se subjektet raportuese e kanë të pamundur të emërojnë një përfaqësues të ri për të përmbushur detyrimet e raportimit, pasi ato nuk marrin shërbim nga regjistrin tregtar ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, për arsye se ato nuk kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues brenda afateve ligjore.

Gjithashtu ky nen përmban dispozita për faljen e gjobave të papaguara, të vendosura nga QKB-ja, për mosregjistrimin fillestar dhe mosregjistrimin e ndryshimeve në të dhënat për pronarët përfitues, brenda afateve ligjore.

Subjektet raportuese të cilave, u është falur gjoba, mbeten të detyruara të përmbushin detyrimet përkatëse të regjistrimit të pronarëve të tyre përfitues, deri më 1.4.2022; në të kundërt, ndaj tyre zbatohen kundërvajtjet administrative të sqaruara më sipër.

Gjithashtu, neni 5 i projektligjit parashikon rimbursimin e gjobave që falen, nga subjektet që i kanë paguar ato, dhe që, brenda datës 1.4.2021, kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues. Ky nen parashikon

delegimin për miratimin nga Këshilli i Ministrave të procedurave të rimbursimit të shumave të gjobave paguara nga subjektet raportuese.

Neni 6 i projektligjit përmban afatin për miratimin nga ana e Këshillit të Ministrave, të akteve nënligjore për mënyrat e rimbursimit të shumave të gjobave të paguara nga subjektet raportuese, në përputhje me parashikimet e pikës 8, të nenit 5, të projektligjit.

Neni 7 i projektligjit parashikon dispozitën e hyrjes në fuqi.

Vlen të theksohet se afati i datës 1.4.2022, parashikuar në projektligj për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, konsideron miratimin e hyrjes në fuqi të projektligjit brenda muajit janar 2022.

Vlerësohet se, për realizimin e popullimit automatik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, të regjistrin të pronarëve përfitues me të dhënat për subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, nevojitet një periudhë pune prej të paktën 2 muajsh.

Gjithashtu, për të mundësuar një numër sa më të lartë të raportimeve nga subjektet e tjera raportuese (me pronësi indirekte dhe organizatat jofitimprurëse), vlerësohet se një afat minimal prej 2 muajsh do të ishte i nevojshëm, pas hyrjes në fuqi të projektligjit dhe botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

Rrjedhimisht, në rast se do të ketë vonesa në procesin e miratimit të projektligjit, do të nevojitej shtyrja e afatit të datës 1.4.2022, gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit në komisionet e Kuvendit apo në seancë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, subjektet raportuese, autoritetet kompetente shtetërore, subjektet e detyruara dhe subjektet raportuese për marrjen e masave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon falje të kundërvajtjeve administrative, si dhe rimbursimin e shumave të paguara lidhur me gjobat e falura. Rrjedhimisht, raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe i shpenzimeve buxhetore është, si më poshtë vijon:

Aktualisht rezulton se rreth 32813 subjekte raportuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, duke përjashtuar subjektet e regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe me statusin pezulluar, të cilët bazuar në vendimin nr.273, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit dhe publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara””, kanë detyrimin të regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarit përfitues përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në regjistrin tregtar, nuk kanë regjistruar pronarin e tyre përfitues brenda afateve ligjore përkatëse. Për rrjedhojë, për këto subjekte raportuese ligji nr.112/2020 parashikon vendosjen e gjobës përkatës dhe ndërprerjen e ofrimit të shërbimit në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.

Duke qenë se sistemi i informatizuar i lejon QKB-së të konstatojë shkeljen dhe, rrjedhimisht, të zbatojë gjobën përkatëse, vetëm në momentin e kryerjes së aplikimit nga subjektet raportuese për regjistrimin e pronarëve përfitues të tyre në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, atëherë rezulton se janë vendosur:

- a) 788 gjoba në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj subjekteve raportuese ekzistuese, mbi bazën e shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, për mospërbushjen e detyrimit të regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues, si dhe në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit, mbi bazën e pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

Ndërkohë, rezulton që 97 subjekte raportuese kanë paguar gjobën prej 400 000 lekësh dhe kanë kryere regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

- b) 139 gjoba në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ndaj subjekteve raportuese të regjistruara pas krijimit të regjistrit të pronarëve përfitues, mbi bazën e shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e

pronarëve përfitues”, të ndryshuar, për mospërbushjen e detyrimit të regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues, si dhe në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit, mbi bazën e pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

Ndërkohë, rezulton që 12 subjekte raportuese kanë paguar gjobën prej 650 000 lekësh dhe kanë kryer regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

Për sa më sipër, rezulton se, në total, janë vendosur 927 gjoba ndaj subjekteve raportuese për mospërbushjen e detyrimit ligjor për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues brenda afatit ligjor përkatës, nga të cilët 109 subjekte raportuese kanë paguar gjobën përkatëse dhe kanë kryer regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

KËSHILLI I MINISTRAVE